



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 18935 Prot.

Vlorë, më 20. 11. 2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ 2024

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SHPENZIME PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE PËR VITIN 2025”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 51, neni 54, pika dh, k dhe në, Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë, neni 112, 113 e në vijim, në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Strukturës Komunitare në Fshat neni 12, në propozimin e Kryesisë së Këshillit si dhe në Relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë ne mbledhjen e datës 30.10.2023:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Kërkesat për shpenzime të domosdoshme për ushtrimin e funksionit të Këshillit të Bashkisë për Vitin 2025 sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Llogaritja e shumës për financimin e shpenzimeve pavarësisht parashikimeve në pikën 1, të realizohet nga Administrata e Bashkisë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.
3. Për zërat e shpenzimeve të parashikuara në Pikën 1 por pa çmimin përkatës, Administrata e Bashkisë të kryejë procedurat përkatëse ligjore dhe të llogarisë shumën përkatëse. Për njoftime televizive të respektohen procedurat ligjore për transmetimet Audio-Vizive duke llogaritur shumën për transmetimin e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë si dhe seancat e Konsultimit Publik që organizohen nga Këshilli i Bashkisë.
4. Ky vendim i përcillet Administratës së Bashkisë dhe bëhet pjesë e Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë si dhe Sekretariati i Këshillit të Bashkisë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë



**KRYETAR**

**Elpiniqi Mërkuri**

*Elpiniqi Mërkuri*

**KËRKESA PËR SHPENZIME PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE TË  
KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË PËR VITIN 2025.**

1. Shpenzime për honorare të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë dhe Kryetarëve të Fshatrave sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit e Sekretariatit të Këshillit të Bashkisë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Shpenzime për ndërtimin e sallës së Këshillit sipas preventivit të përgatitur nga grupi i ekspertëve.
4. Njoftime televizive, transmetim i mbledhjeve të Këshillit dhe konsultimit publik të organizuara nga Këshilli i Bashkisë sipas procedurave të prokurimit publik.
5. Sistem Ngrohje-Ftohje i sallës së mbledhjeve të Këshillit në pallatin e Kulturës sipas preventivit të përgatitur nga ekspertët.

<b>NR.</b>	<b>EMËRTIMI I SHPENZIMEVE</b>	<b>VLERA VJETORE</b>
1	Botime periodike( raporti vjetor i veprimtarisë së këshillit, Gazeta juridike e Këshillit, fletëpalosje)	130,000
2	Fushatë Këshillimi me qytetarët	180,000
3	Botime të tjera: Përmbledhje 4 vjecare e vendimeve të Këshillit	150,000
4	Blerje karta urimi për ftesat zyrtare	25,000
5	Dërgim me postë i dokumenteve, shkresave të Këshillit dhe Këshilltarëve	12,000
6	Kancelari për zyrë	150,000
7	Shpenzime udhëtimi	500,000
8	Kompjuter zyre (2 copë)	216,000
9	Printer (1 copë)	50,000
10	Rafte	150,000
11	Vizita studimore të Këshilltarëve	2,000,000
12	Trajnime për Këshilltarët	1,000,000
13	Shpenzime për pritje/përcjellje	300,000
14	Shpenzime për mbledhjet e Këshillit	100,000
15	Mikrofona(x13)	350,000
16	Flamuri Kombetar, Flamuri i Bashkisë për sallën e Këshillit, dhe Logo e Bashkisë(x3)	120,000
17	Shpenzime për shërbime financiare	1,000,000
18	Shpenzime operative të paparishkuara	250,000
<b>SHUMA TOTALE</b>		<b>6,683,000</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 18935 Prot.

Vlorë, më 20 . 11 . 2024

**RELACION**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ 2023

**“MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SHPENZIME PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE PËR VITIN 2025”**

Të nderuar Këshilltarë!

Bazuar në Ligjin 68/2017 dt. 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Këshilli i Bashkisë brënda muajit dhjetor miraton Buxhetin e Bashkisë për vitin pasardhës. Projektvendimi që po ju paraqesim lidhet me kërkesat për shpenzime të Këshillit të Bashkisë përse i përket shpenzimeve të domosdoshme për vitin 2025 për ushtrimin e funksioneve të tij, i cili duhet të bëhet pjesë e buxhetit të Bashkisë për këte vit buxhetor.

Në treguesit e parashikuar nuk ka ndryshime për zëra shpenzimesh në krahasim me ato të planifikuarat për vitin 2024. Kjo pasi gjatë këtij viti, Administrata e Këshillit u plotësua vetëm me 1 fotokopje dhe 1 kompjuter, ndërkohë që kërkesat e tjera për vitin 2024 të cilat nuk u plotësuan mbeten në fuqi edhe për vitin 2025. Në tabelën bashkëlidhur këtij projektvendimi janë pasqyruar shpenzimet për honoraret për Këshilltarët, për Kryetarët e Fshatrave, paga e sigurimeve shoqërore për punojnësit e Sekretariatit të Këshillit, si dhe shpenzimet operative dhe disa investime të domosdoshme për funksionimin normal të Administratës dhe Këshillit të Bashkisë.

Theksojmë se këtë projektvendim e paraqesim për miratim në Këshillin e Bashkisë, në referim të nenit 113 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë”, sipas të cilit është parashikuar që Këshilli i Bashkisë miraton shpenzimet e domosdoshme për të mundësuar ushtrimin normalisht të funksioneve të tij dhe ja paraqet Administratës së Bashkisë për ta bërë pjesë të Buxhetit Vjetor të Bashkisë.

Sikurse theksuam më lartë, në tabelën që shoqëron projektvendimin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar gjitha kërkesat për shpenzimet e vlerësuara të domosdoshme. Në kërkesat e parashtruara janë reflektuar edhe vrejjet dhe propozimet e këshilltarëve.

Për kërkesat në të cilat nuk janë reflektuar shumat përkatëse në leke në tekstin e paraqitur, por që vlerësohen të domosdoshme, i është kaluar si kopetencë Administratës së Bashkisë që bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të përcaktoje procedurën ligjore si dhe cëmimin përkatës. Kjo pasi aktualisht nga ana e Sekretariatit të Këshillit nuk mund të përcaktohej cërimi paraprakisht. Për rrjedhojë po ja paraqesim Administratës së Bashkisë vetëm si kërkesa për objektin e shpenzimeve. Këto kërkesat në momentin e miratimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 duhet të reflektohen sipas shumave përkatëse që do të llogarisë Administrata e Bashkisë.

Në tabelën bashkëlidhur këtij projektvendimi, një vënd të rëndësishëm zë ndërtimi i sallës së Këshillit të Bashkisë e cila edhe pse ka qënë e planifikuar prej disa vitesh buxhetorë nuk janë realizuar procedurat përkatëse, gjë që kërkon nga Administrata e Bashkisë të vlerësohet seriozisht pasi sikurse theksuam jo vetëm që është e domosdoshme por mund të kthehet në problem për shkak se është prishur objekti ekzistues.

Pavarësisht sa më lartë, Këshilltarët mund të propozojnë ndryshime, paksime ose shtesa të cilat mund të bëhen pjesë e këtij projekti kërkesash të paraqitur për miratim.

Nga sa më lartë, propozojmë të miratoni këto kërkesa me qëllim që ti përcillen Administratës së Bashkisë e cila aktualisht është duke realizuar procedurat përkatëse për hartimin dhe miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025.

**KRYETAR**  
**Elpiniqi Mërkuri**

  
